



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE DHE KOMPJUTERIKE

Bregu i Diellit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +383-38-554896

Fax: +383-38-542525 E-mail: fiek@uni-pr.edu www.uni-pr.edu

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
Fakulteti i inxhinierise elektrike dhe kompjuterike
Nr. 3382/26
Dt. 15.09.26
PRISHTINE

Për: Këshillin e FIEK

Dekanin, Prof.dr. Isak Shabani

Nga: Prof.dr. Mimoza Ibrani, anëtare e Komisionit të ankesave

CC: Komisioni i ankesave Prof.dr. Blerim Rexha (kryetar), Prof.dr. Sabrije Osmanaj (anëtare)

RAPORT

Këshilli i FIEK ka emëruar komisionin për shqyrtimin e ankesave në konkursin për pranimin e studentëve të rinj në nivelin e doktoratës për vitin akademik 2026/27, në përbërje : Prof.dr. Blerim Rexha -kryetar, Prof.dr. Sabrije Osmanaj -anëtare, dhe Prof.dr. Mimoza Ibrani -anëtare. Bazuar në Vendimin 2888/26, komisioni ka për obligim të shqyrtoi ankesat e kandidatëve lidhur me mospranimin në FIEK.

Takimi i Komisionit është ftuar nga kryetari ku edhe janë shqyrtuar ankesat dhe dokumentacioni i kandidatëve. Pas shqyrtimeve dhe diskutimeve, anëtarët janë pajtuar që secili të përgatis raport të ndarë.

Bazuar në Statutin e Universitetit të Prishtinës, Rregulloren për studime të doktoratës (Nr. Prot.1/147,dt.16.04.2026), Konkursin për studime të doktoratës për vitin akademik 2026/2027 (Prot.1/345,dt. 07.05.2026), Rezultatet preliminare të Konkursit të shpallura nga Komisioni i FIEK (315/25, dt. 07.07.2026), si dhe ankesat e kandidatëve të cilët nuk rangohen për pranim, paraqes këto konstatime dhe vlerësime:

1. Në përputhje me Vendimin nr. 2888/26, në këtë raport janë shqyrtuar vetëm ato pretendime të paraqitura në ankesa që bien në kompetencën e Komisionit për ankesa. Pretendimet që kanë të bëjnë me çështje jashtë kompetencave të Komisionit nuk janë objekt i këtij shqyrtimi dhe i referohen për trajtim strukturave dhe organeve kompetente të Fakultetit dhe Universitetit.

2. Rezultatet preliminare të Konkursit të shpallura nga Komisioni i FIEK janë të bazuara edhe në:

*Vendimin e marrë me shumicë votash nga Këshilli i Studimeve të Doktoratës në FIEK, më datë 03.07.2026, lidhur me kandidatët që nuk i kanë përfunduar studimet paraprake bachelor dhe master në fushën e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike; K1

* Njoftimin për listën e mentorëve potencialë, të pranuar nga Dekanati i FIEK-ut më datë 03.07.2026; K3

3. Rregullorja për studimet e doktoratës i njeh njësisë akademike kompetencën për të përcaktuar fushat e afërta me programin e doktoratës dhe për t'i publikuar ato në konkurs, në kuadër të kushteve të veçanta. Në rastin konkret, Konkursi i shpallur, tek pjesa e Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, ka përcaktuar se të drejtë aplikimi kanë kandidatët që kanë përfunduar studimet Bachelor dhe Master në Inxhinieri Elektrike dhe Kompjuterike, pa përcaktuar fusha të tjera të afërta. Për rrjedhojë, konsiderohet se Senati me miratimin e Konkursit ka ushtruar kompetencën rregullative duke kufizuar të drejtën e aplikimit vetëm për kandidatët që kanë përfunduar studimet në këtë fushë.

4. Rregullorja për studimet e doktoratës përcakton se vlerësimi i fushës së studimeve të kandidatëve, të cilët studimet paraprake i kanë përfunduar në fakultete ose universitete të tjera, bëhet nga Këshilli i Studimeve të Doktoratës, para se kandidatët t'i nënshtrohen prezantimit publik. Rrjedhimisht, vlerësimi i përputhshmërisë së fushës së studimeve paraprake me kushtet e veçanta të përcaktuara në konkurs, si dhe konstatimi nëse kandidati i plotëson kushtet për të vazhduar procedurën e pranimit, është në kompetencë të Këshillit të Studimeve të Doktoratës.

5. Pas shqyrtimit të ankesave të kandidatëve: Alketa Sahiti, Eliona Aliju Ballazhi, Ilir Osmanaj, Kastriot Fetahaj, Arlinda Sheholli Prekadini, Alma Novobërdaliu dhe Ariana Kadriu, konstatohet se të gjitha ankesat janë të lidhura kryesisht me pretendimet për përmbushjen e kritereve K1 dhe K3.

K1 Fusha e studimeve paraprake

K3 Letër zotimi nga mentori potencial i cili i plotëson kushtet për mentorim

Alketa Sahiti K3	Kandidatja ka dorëzuar letër zotim nga mentori potencial. Komisioni për pranimin e kandidatëve, me rastin e shpalljes së rezultateve preliminare, ka konstatuar se mentori potencial i propozuar nga kandidatja nuk figuron në listën e mentorëve potencialë që i plotësojnë kriteret për mentorim, të përpiluar dhe të përcjellë nga Dekanati i FIEK-ut në zbatim të Rregullores për studimet e doktoratës. Për rrjedhojë, kandidatja nuk është përfshirë në listën e kandidatëve të pranuar.	Ankesa konsiderohet e pabazuar
Eliona Aliju Ballazhi K1	Kandidatja pretendon diploma e saj në nivelin master duhet të konsiderohet si "fushë e afërt". Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave nuk ka kompetencë të bëjë ekuivalentimin e fushave ose programeve studimore, pasi kjo kompetencë u takon organeve kompetente të përcaktuara me Rregulloren dhe Konkursin. Këshilli i Studimeve të Doktoratës në FIEK, më datë 03.07.2026, ka marrë vendim se kandidatja nuk	Ankesa konsiderohet e pabazuar

	konsiderohet se ka përfunduar studimet paraprake Bachelor dhe Master në Inxhinieri Elektrike dhe Kompjuterike.	
Ilir Osmanaj K1 dhe K3	Lidhur me kriterin K1, kandidati pretendon se studimet Master në programin Data Science në <i>Technische Universität Wien</i> duhet të konsiderohen si studime në fushë të njëjtë ose të afërt me programin e doktoratës në Inxhinieri Elektrike dhe Kompjuterike. Kandidati ka dorëzuar edhe dokumentin sipas të cilit njohja/barasvlera e studimeve master Dipl.Ing. Data Science në TUWIEN është në procedurë në MASHT . Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave nuk ka kompetencë të bëjë ekuivalentimin e fushave ose programeve studimore, pasi kjo kompetencë u takon organeve kompetente të përcaktuara me Rregulloren dhe Konkursin. Këshilli i Studimeve të Doktoratës në FIEK, më datë 03.07.2026,ka marrë vendim se kandidati nuk konsiderohet se ka përfunduar studimet paraprake Bachelor dhe Master në Inxhinieri Elektrike dhe Kompjuterike. Kandidati ka dorëzuar letër zotim nga mentori potencial. Komisioni për pranimin e kandidatëve, me rastin e shpalljes së rezultateve preliminare, ka konstatuar se mentori potencial i propozuar nga kandidati nuk figuron në listën e mentorëve potencialë që i plotësojnë kriteret për mentorim, të përpiluar dhe të përcjellë nga Dekanati i FIEK-ut në zbatim të Rregullores për studimet e doktoratës. Për rrjedhojë, kandidati nuk është përfshirë në listën e kandidatëve të pranuar.	Ankesa konsiderohet e pabazuar
Kastriot Fetahaj K1 dhe K3	Lidhur me kriterin K1, kandidati pretendon se programi Master në Shkenca Kompjuterike duhet të konsiderohet si program në fushën e njëjtë ose të afërt me programin e doktoratës në Inxhinieri Elektrike dhe Kompjuterike. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave nuk ka kompetencë të bëjë ekuivalentimin e fushave ose programeve studimore, pasi kjo kompetencë u takon organeve kompetente të përcaktuara me Rregulloren dhe Konkursin. Këshilli i Studimeve të Doktoratës në FIEK, më datë 03.07.2026,ka marrë vendim se kandidati nuk konsiderohet	Ankesa konsiderohet e pabazuar

	se ka përfunduar studimet paraprake Bachelor dhe Master në Inxhinieri Elektrike dhe Kompjuterike. Kandidati ka dorëzuar letër zotim nga mentori potencial. Komisioni për pranimin e kandidatëve, me rastin e shpalljes së rezultateve preliminare, ka konstatuar se mentori potencial i propozuar nga kandidati nuk figuron në listën e mentorëve potencialë që i plotësojnë kriteret për mentorim, të përpiluar dhe të përcjellë nga Dekanati i FIEK-ut në zbatim të Rregullores për studimet e doktoratës. Për rrjedhojë, kandidati nuk është përfshirë në listën e kandidatëve të pranuar.	
Arlinda Sheholli Prekadini K3	Kandidatja ka dorëzuar letër zotim nga mentori potencial. Komisioni për pranimin e kandidatëve, me rastin e shpalljes së rezultateve preliminare, ka konstatuar se mentori potencial i propozuar nga kandidatja nuk figuron në listën e mentorëve potencialë që i plotësojnë kriteret për mentorim, të përpiluar dhe të përcjellë nga Dekanati i FIEK-ut në zbatim të Rregullores për studimet e doktoratës. Për rrjedhojë, kandidatja nuk është përfshirë në listën e kandidatëve të pranuar.	Ankesa konsiderohet e pabazuar
Alma Novobërdaliu K1	Kandidatja pretendon se studimet e saja paraprake duhet të konsiderohet fushë e afërt me programin e doktoratës, se nuk janë publikuar fushat e afërta dhe se është privuar nga e drejta për intervistë. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave nuk ka kompetencë të bëjë ekuivalentimin e fushave ose programeve studimore, pasi kjo kompetencë u takon organeve kompetente të përcaktuara me Rregulloren dhe Konkursin.	Ankesa konsiderohet e pabazuar

	Këshilli i Studimeve të Doktoratës në FIEK, më datë 03.07.2026,ka marrë vendim se kandidatja nuk konsiderohet se ka përfunduar studimet paraprake Bachelor dhe Master në Inxhinieri Elektrike dhe Kompjuterike.	
Ariana Kadriu K1 dhe K3	Kandidatja pretendon se studimet Bachelor në Informatikë Inxhinierike, së bashku me studimet Master në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, përmbushin kushtet e konkursit. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave nuk ka kompetencë të bëjë ekuivalentimin e fushave ose programeve studimore, pasi kjo kompetencë u takon organeve kompetente të përcaktuara me Rregulloren dhe Konkursin. Këshilli i Studimeve të Doktoratës në FIEK, më datë 03.07.2026,ka marrë vendim se kandidatja nuk konsiderohet se ka përfunduar studimet paraprake Bachelor dhe Master në Inxhinieri Elektrike dhe Kompjuterike. Kandidatja ka dorëzuar letër zotim nga mentori potencial. Komisioni për pranimin e kandidatëve, me rastin e shpalljes së rezultateve preliminare, ka konstatuar se mentori potencial i propozuar nga kandidatja nuk figuron në listën e mentorëve potencialë që i plotësojnë kriteret për mentorim, të përpiluar dhe të përcjellë nga Dekanati i FIEK-ut në zbatim të Rregullores për studimet e doktoratës. Për rrjedhojë, kandidatja nuk është përfshirë në listën e kandidatëve të pranuar. Lidhur me kriterin K3, kandidatja kërkon që t'i lejohej zëvendësimi i letrës së zotimit me një mentor tjetër, pasi mentori i propozuar kishte arritur numrin maksimal të kandidatëve që mund të mentoronte. Sipas pikës III.9 të konkursit, dokumentacioni i kërkuar duhej të dorëzohej brenda afatit të aplikimit. Pas	Ankesa konsiderohet e pabazuar

	përfundimit të këtij afati nuk ekziston bazë juridike për plotësimin ose zëvendësimin e dokumentacionit që ndikon në përmbushjen e kushteve të konkursit, pasi një veprim i tillë do të cenonte parimet e barazisë së kandidatëve, sigurisë juridike dhe trajtimit të barabartë në procedurën konkurruese	
--	--	--

Prishtinë, 15.07.2026

Prof.dr. Mimoza Ibrani

